



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade



API

Agjencia për Pronësi Industriale
Agencija za Industrijsku Svojину
Industrial Property Agency

RAPORT VJETOR 2022

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë/Republika e Kosovës
Tel: +381 38 200 36 554
Web: www.kipa.rks-gov.net

Hyrje

Agjencia për Pronësi Industriale (API) është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë për Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti dhe është institucioni i vetëm i ngarkuar në Kosovë për administrimin dhe promovimin e të drejtave të pronësisë industriale, detyrim i cili buron nga neni i 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

API është institucioni i vetëm në Kosovë nëpërmjet të cilit shteti i Kosovës mbron markat tregtare, jep të drejtat e patentës mbi shpikjet, mbron dizajnet industriale, treguesit gjeografikë, topografite e produkteve të gjysëmperçues, duke ju njohur pronarëve të drejtës e pronësisë të fituar nëpërmjet procedurës së regjistrimit.

Agjencia për Pronësi Industriale është përgjegjëse dhe mban rolin primar në zbatim të Kapitullit VII të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, i cili obligon Kosovën për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Agjencia për Pronësi Industriale ka mision të forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale mbrenda territorit të Kosovës nëpërmjet regjistrimit dhe promovimit të mbrojtës së pronësisë industriale, Mbrojtja e pronësisë industriale bazohet në legjislacionin kombëtar të cilat janë në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe Acquis e BE.

Ky raport vjetor shërben si një komunikim i hapur me publikun mbi punën e Agjencisë për Pronësi Industriale, sfidat me të cilat përballet dhe rritjen e ndërgjegjesimit mbi fushën e pronësisë industriale në Republikën e Kosovës.

Duke ditur se pronësia intelektuale po bëhet gjithnjë e më rëndësishme në tregtinë ndërkombëtare dhe rritjen ekonomike të shteteve, Agjencia me besimin dhe përkushtimin e duhur është duke punuar në zhvillimin e sistemit të pronësisë industriale në Kosovë dhe arritjen e objektivave strategjike për një sistem që garanton mbrojtjen dhe promovimin e pronësisë industriale.

Raporti i mëposhtëm është i ndarë në pjesë të veçanta dhe përmban statistika të lëndëve të pranuar, punës së stafit të Agjencisë për Pronësi Industriale, shërbimet të cilat ofrohen nga Agjencia, aktivitetet të cilat janë organizuar për promovimin e pronësisë industriale dhe forcimin e kapaciteteve administrative të stafit të saj.

Duke ju dëshiruar vit të mbarë

JU FALENDEROJMË


1. Pranimit i aplikimeve dhe kërkesave tjera nga palët

Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar aktivitetin e saj në pranimin e aplikimeve për objekte të pronësisë industriale, si: Marka Tregtare; Patenta; Dizajne Industriale; kundërshtime të markave të publikuara; hulumtime të markave tregtare; aplikime për patenta; ekzaminime të parakohshme; vazhdime të markave tregtare; ndryshime në regjistër; kërkesa për mbajtje në fuqi; dokumente të përparësisë; ndërrim përfaqësuesi; autorizime gjenerale; ankesa në komision të ankesave; vendime të komisionit të ankesave dhe dokumentacione tjera shtesë.

Gjatë kësaj periudhe kohore në zyrën e pranimit të dokumentacionit të API-së janë pranuar **7518** kërkesa të ndryshme, të cilat i kemi pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela e kërkesave të pranuar për vitin 2022	
Marka Tregtare aplikime	1974
Patenta aplikime	26
Dizajn Industriale aplikime	25
Kërkesa për vazhdime të markave tregtare	1342
Kërkesa për ndryshime në regjistër të markave tregtare, patentave dhe dizajneve industriale	591
Kërkesa për plotësime të Markave Tregtare, taksa për lëshimin e vendimit dhe taksa për lëshimin e certifikatës për Marka Tregtare, pagesa të patentave dhe dizajnit industrial	1944
Kërkesa për ekzaminimin e parakohshëm të markave tregtare	26
Autorizime	149
Kërkesa për mbajtje në fuqi të patentave	353
Kundërshtime të Markave Tregtare	114
Kërkesa për heqje dorë të markave tregtare dhe patentave	42
Kërkesa për ekstrakt regjistri	29
Kërkesa për vazhdimin e dizajnit industrial	23
Dokumente prioriteti	174
Kërkesa për informacione të markave tregtare dhe patentave	56
Mirëmbajtje vjetore të licencës së përfaqësuesve	38
Ankesa kundër vendimeve të API-së	42
Vendim i komisionit të ankesave	24
Kërkesa për rivendosje të MT	7
Kërkesa nga pala dhe kërkesa për përmirësimin	308
Vërejtje kundër markës së publikuar	17
Kërkesë për shfuqizim vendimi dhe revokim	15
Dokumenti i ri	152
Përgjigje në kërkesën për kundërshtimin e MT	47

Tabela 1. Numri i dokumenteve hyrëse, Janar - 16 Dhjetor 2022




2. Ekzaminimi i aplikimeve / shqyrtimi i kërkesave

Patenta

Numri i aplikimeve të patentave vazhdon të jetë në nivelin e ulët, kjo për shkakun e mos anëtarësimit të Kosovës në EPO (Zyra Evropiane e Patentave), dhe industrisë jo të zhvilluar inovative e cila lidhet me aplikimin e patentave me aplikues vendor. Me rastin e anëtarësimit të Kosovës në Zyrën Evropiane të Patentave, pritet të rritet numri i aplikimeve për patenta, kjo pasi zvogëlohet kostoja dhe koha e aplikimit, duke krahasuar me mbrojtjen nacionale që aplikohet tashmë në Kosovë.

Ekzaminimi i aplikimeve për patenta kryhet brenda 18 muajve, duke llogaritur nga data e dorëzimit të aplikimit për patentë. Pronari i patentës është i obliguar të dorëzoj dëshmi me shkrim që shpikja është e patentuar, është e re dhe ka hap shpikës, më së voni pas skadimit të vitit të nëntë të afatit të patentës së dhënë nga Agjencia.



Njoftim për plotësimin e aplikacioneve për patentë	16
Njoftim për pagesën e tarifave për lëshimin e vendimit për njohje	14
Vendim për njohjen e patentës	15
Vendim të tërësishme – pjesërisht të patentave	2
Hulumtime në regjistrin e patentave	20
Hapa në sistemin IPAS	3471
User doc acceptance, pranimi i mbajtjeve në fuqi pas kontrollimit, dhe i dokumenteve tjera përcjellëse të hyra si user dokumente për aplikimet dhe regjistrin e patentave	263
Mbatje në fuqi të kontrolluara dhe chekuara	343
Vendime për refuzimin e patentave	19


Tabela 2. Statistika vjetore të sektorit të patentave 2022

Marka Tregtare

Numri i aplikimeve për marka tregtare vazhdon të mbajë trendin dhe mesataren e njëjtë të aplikimeve në vite, ndërsa numri i aplikimeve me aplikues vendor ka shënuar rritje. Kjo rritje i atribuohet aktiviteteve promovuese të mbajtura nga Agjencia dhe Projekti i Mbështetës EU-IPR në Kosovë.

API ka vazhduar me shqyrtimin e aplikimeve për marka tregtare ku janë përfunduar shqyrtimet e aplikimeve paraprake, dhe po vazhdohet me shqyrtimet e aplikimeve të markave tregtare të pranura gjatë vitit 2022.

Deri tek regjistrimi i një marke tregtare e cila nuk pranon kundërshtim gjatë publikimit, Agjencia duhet të ndjekë disa hapa, si: ekzaminimi formal i aplikacionit për markë tregtare, ekzaminimi lidhur me bazat absolute të refuzimit, publikimi i aplikimit, lëshimi i ftesën për pagesën e regjistrimit dhe në fund lëshimi i vendimit për regjistrimin e një markë tregtare. Regjistrimi i një marke tregtare në Agjenci për aplikimet të cilat nuk pranojnë kundërshtime bëhet në kohë relativisht të shpejtë krahasuar me kohën e ekzaminimit të aplikimeve nga vendet rajonale apo të tjera.



Vendime për regjistrimin e markave tregtare	1494
Publikime të markave tregtare pas ekzaminimit	2110
Njoftime për plotësimin e aplikacioneve	72
Njoftime për heqje dorë të markave tregtare	20
Vendime për ndryshimin në regjistër të markave tregtare dhe përfaqësuesve të autorizuar	909
Vendime për vazhdimin e markave tregtare	1408
Lëshimi i certifikatave për marka tregtare	1389
Ftesë për pagesën e vendimit për markë tregtare	1662
Ekstrakte regjistri	15
Vendime për refuzimin e MT	44
Ftesa për përgjigje në kundërshtimin e markave tregtare	373
Vendime shqyrtimin e kundërshtimeve të markave tregtare	172


Tabela 3. Statistika vjetore të sektorit të markave tregtare gjeneruar përmes IPAS

Dizajni Industrial

Si tek aplikimet për patenta ashtu dhe tek aplikimet për dizajn industrial, numri i aplikimeve nuk është i kënaqshëm, kjo për shkakun e zhvillimit industrial që korrespondon me zhvillimin e produkteve të reja në Kosovë. Me dizajn industrial mbrohet dukja e jashtme e produktit. Produkti duhet të ketë karakter individual dhe të jetë i ri në fushën përkatëse.

Njoftime për plotësimin e Dizajnit Industrial	25
Vendime për vazhdimin e Dizajnit Industrial	25
Vendime për regjistrimin e Dizajnit Industrial	43
Certifikata për Dizajnin Industrial	5
Ftese për pagesën e regjistrimit të DZ	32
Vendime për vazhdimin e dizajnit industrial	25

Tabela 4. Statistika vjetore të dizajnit industrial 2022



Përmbledhja statistikore e punës vjetore

Është nxjerrë vendimi me numër regjistrimi **30000 për marka tregtare**. Kjo është një e arritur e madhe e Agjencisë dhe dëshmon përkushtimin për ngritjen e cilësisë dhe shpejtësisë në ofrimin e shërbimeve për palët.

Nga të dhënat statistikore të nxjerra në sistemin IPAS del se zyrtarët e API-së gjatë vitit 2022 kanë kryer gjithsejti **26105** hapa në sistem. Hapat përfshijnë kalimin nga një procedurë e ekzaminimit në procedurën tjetër.

Janë lëshuar **7269** dokumente dalëse, vendime, certifikata, ftesa, për përfundimin e proceseve të shqyrtimit të aplikimeve.

Gjatë këtij viti janë skanuar, indeksuar dhe dërguar në server **12465** shkresa hyrëse dhe dalëse, që e bën procesin e pranimit dhe lëshimit të dokumenteve të nga forma elektronike shume me te lehte dhe shpejte.

Treguesi Gjeografikë: në lidhje me fushën e treguesit gjeografikë, me 15 Shtator dhe 21 Nëntor janë mbajtur takimet me komisioni për vlerësimin e treguesve gjeografike. Komisioni ka shqyrtuar 4 aplikacione dhe është pajtuar që të ri-shikohen disa aplikacione për mungese dokumentacioni. Palët janë njoftuar për mangësitë në aplikacion dhe komisioni do të mbledhen pas marrjes së përgjigjeve finale. Në procedurë të regjistrimit janë 2 tregues vendor, Djathi i Sharrit dhe Verëra e Rahovecit.

3. Kundërshtimet e regjistrimit të markës tregtare dhe kërkesat për deklarim të shfuqizimit

Agjencia ka filluar me lëshimin e vendimeve për kundërshtimin e markave tregtare. Pas një procesi të gjatë ku janë trajnuar zyrtarët e Agjencisë, këtë vit për here të parë që nga themelimi i Agjencisë, është filluar për mos u ndalur me lëshimin e vendimeve për kundërshtimin e MT, dhe me këtë është zgjedhur problemi me i madhe që ka ekzistuar në Agjencia ndër vite, së paku 10 vite të pa shqyrtuara lëndët e kundërshtimeve.

Ky rast konsiderohet dhe është një e arritur e madhe për Agjencinë për Pronësinë Industriale dhe gjithë sistemin e mbrojtjes dhe regjistrimit të pronës industriale në Kosovë, pasi ky proces i bllokuar deri më tani ka gjetur zgjidhje të përhershme. Në javët në vazhdim, Agjencia do të vazhdojë me shqyrtimin e rasteve të kundërshtimeve deri në zgjidhjen e të gjitha kërkesave të pranuar ndër vite.

Agjencia para fillimit të shqyrtimit të kërkesave për kundërshtime ka organizuar trajnimin e stafit të saj. Janë realizuar 4 sesione trajnimi 5 ditore për shqyrtimin e kundërshtimeve të markave tregtare. Këto trajnime janë mbështetur nga projekti IPR. Eksperti i angazhuar ka punuar ngushtë dhe në mënyrë fizike me zyrtarët e Agjencisë duke i trajnuar për mënyrat më të mira dhe praktikat më të mira të shqyrtimit të kundërshtimeve për marka tregtare.

Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar **373** ftesa për përgjigje në kundërshtimet e pranuar. Ky proces është parakusht për të vazhduar me shqyrtimin përmbajtjesor të kundërshtimit.

Si të përfunduara janë **172** kërkesa për kundërshtime duke është duke vazhduar trajnimi i kërkesave tjera të pashqyrtuara. Shqyrtimi do të vazhdon duke ditur dhe tashmë janë vënë bazat dhe krijuar praktikat për mos ndaljen e shqyrtimit të kundërshtimeve deri në përfundimin e tyre.

4. Publikimi i Buletinit të Agjencisë

Agjencia për Pronësi Industriale gjatë këtij viti ka publikuar **4** Buletine Zyrtare me **1794** objekte të pronësisë industriale të cilat përfshijnë: aplikime të markave tregtare, vendime për regjistrimin e markave tregtare, ndryshimet në regjistër, vazhdimet e markave tregtare, regjistrimet e patentave dhe dizajnit industrial.

Duke u mbështetur në buletin, pronarët e markave të mëhershme të cekur në nenin 34 të Ligjit për Marka Tregtare Nr. 08/L-075 mund të paraqesin kundërshtimet e tyre. Këto kundërshtime duhet të dorëzohen brenda periudhës kur Buletini Zyrtar është i hapur apo brenda 3 muajve nga data e publikimit të Buletinit Zyrtar.

Përveç Buletinit, Agjencia në ueb faqen e saj publikon dhe regjistrin online ku publiku mund të kërkoj për objekte të pronësisë industriale dhe aplikuesit mund të shikojnë procesin e shqyrtimit të aplikacionit të tyre.

Linku për qasje në Buletinet Zyrtare të Agjencisë <https://kipa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,47>



5. Digjitalizimi i API-së, Sistemi IPAS, WipoScan, WipoPublish dhe Web faqe

Ka vazhduar përditësimi i regjistrimit online për objektet e pronësisë industriale. Ky regjistër përditësohet çdo ditë kalendarike. Sipas legjislacionit, markat tregtare publikohen nga momenti i aplikimit ndërsa patentat dhe dizajnet industriale publikohen në regjistër vetëm pas regjistrimit dhe publikimit të tyre në Buletinin Zyrtar.

The screenshot displays the homepage of the KIPA (Kosovo Intellectual Property Agency) website. At the top right, there are links for 'About', 'Shqip' (with a dropdown arrow), and '(0)'. Below these are navigation tabs for 'Dizajn', 'Patenta', and 'Marka tregtare'. The main heading is 'SISTEMI I KËRKIMIT TË AGJENCISË PËR PRONËSI INDUSTRIALE', with a subtitle 'Patentat, Dizajnat industriale dhe Markat Tregtare të deponuara në Kosovë'. A secondary heading reads 'PATENTA, DIZAJN INDUSTRIALË DHE MARKAT TREGTARE TË DEPOZITUARA NË KOSOVË'. Below this, there are filters for 'Flamuri' (Kosova) and 'Shteti' (Kosova). Three data points are shown: 'Patenta' with 1003, 'Dizajn' with 33, and 'Marka Tregtare' with 35813. At the bottom, there is a search bar labeled 'KERKO' with the text 'Basic or advanced search to refine your preferences' and an 'EXPORTO' button with the text 'Exporto rezultatet në PDF'. The WIPO logo is visible in the bottom left corner, and 'powered by WIPO' is in the bottom right corner.

Ky sistem i ofruar nga WIPO mundëson që palët të bëjnë kërkime për marka tregtare dhe të shohin statusin e aplikimeve të tyre, kjo krijon transparence tek palët pasi ato mundën në çdo kohë të verifikojnë rrjedhjen e shqyrtimit të lëndës së tyre.

API gjatë vitit 2022 ka publikuar aktivitetet kryesore në web faqen e saj, janë krijuar **19** lajme dhe publikuar në web faqen www.kipa.rks-gov.net.

6. Seminare & Aktivitete

Është miratuar Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2022 për Caktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Përdorimin e Logos së Agjencisë për Pronësi Industriale. Logoja e re e dizajnuar do të shërben si identitet për Agjencinë në komunikimet me palët dhe identifikim e saj me të lehtë tek bizneset.

Është miratuar Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2022 për Përfaqësues të Autorizuar për Pronësinë Industriale.

Është miratuar Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2022 për Kompetencat, Mandatin dhe Punën e Komisionit të Ankesave kundër Vendimeve të Agjencisë për Pronësi Industriale.

Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) në bashkëpunim me Agjencinë për Pronësi Industriale dhe IPR Project, organizoi sesionin Informues për bizneset anëtare. Agjencia për Pronësi Industriale u përfaqësua nga Zv. Drejtori, Dukaj. Në këtë takim u diskutua mbi pronësinë industriale me theks regjistrimin e patentave, markave tregtare dhe dizajnit industrial.



Një delegacion i kryesuar nga Drejtoresha e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, Znj. Rovena Beqiraj, qëndroi për vizitë në Agjencinë për Pronësi Industriale. Gjatë takimit u diskutuan mënyrat e bashkëpunimit të zyrave homologe në fushën e pronësisë industriale, bashkëpunim ky i formalizuar me marrëveshjen e bashkëpunimit, arritur gjatë vitit 2018. Qëllimi i bashkëpunimit është të arrihen objektivat të cilat përfshijnë shkëmbimin e ndërsjellët të eksperiencës, informacionit dhe publikimeve në fushën e pronësisë industriale, bashkëpunimit reciprok në harmonizimin e legjislacionit, politikave strategjike dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e pronësisë industriale.



Është mbajtur trajnimi për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të organizuar nga projekti IPR dhe Akademia e Drejtësisë. Në këtë trajnim morën pjesë Gjykatës dhe Prokurorë si dhe institucionet e pronësisë intelektuale të zbatimit. Si përfituesit kryesor të këtij projekti, API mori pjesë në këtë trajnim ku u ndanë eksperiencat me të mira për shqyrtimin e objekteve të pronësisë industriale bazuar në praktikën e zyrave të EU dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Është arritur miratimi i ligjeve të pronësisë industriale si pjesë e reformës ligjore sipas zotimeve të marra në marrëveshjen e stabilizimit asociimit. Agjencia së bashku me projektin dhe grupet punuese kanë punuar në përgatitjen e draft ligjeve dhe ato janë dërguar për miratim në Qeveri dhe për miratim final në Parlamentin e Kosovës. Për herë të parë është miratuar dhe Ligji për Sekretin Tregtar i cili transponon Direktivën e (BE) 2016/943. Me miratimin e këtyre ligjeve konsiderojmë se baza ligjore e pronësisë industriale është e harmonizuar plotësisht me Aquies – BE.

Janë miratuar këto ligje:

- Ligji Nr. 08 L/059 për Patentat;
- Ligji Nr. 08 L/055 për Dizajnin Industrial;
- Ligji Nr. 08 L/053 për Topografitë e Gjysëmpërçuesve;
- Ligji Nr. 08 L/076 për Mbrojtjen e Sekreteve Tregtare;
- Ligji Nr. 08 L/075 për Marka Tregtare

Në kuadër të zbatimit të marëveshjes së bashkëpunimit në mes Agjencisë për Pronësi Industriale të Republikës së Kosovës dhe Drejtorisë së Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë, u mbajt sesiioni promovues i pronësisë industriale me studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës. Përfaqësuesit e Agjencisë ishin pjesë e panelit ligjerues, ku u ligjerua mbi të drejtat e pronësisë industriale, regjistrimi dhe përfitimi nga regjistrimi i objekteve të pronësisë industriale. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta në mes të zyreve homologe është pjesë e planit të zbatimit të marëveshjes së bashkëpunimit.



Në vazhden e organizimit të aktiviteteve për shënimin e Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, Agjencia për Pronësi Industriale, Zyra për të Drejtat e Autorit, Dogana e Kosovës dhe Projektin IPR i BE, në bashkëpunim me Kolegjin UBT, organizuan një aktivitet promovues mbi pronësinë intelektuale. Zv. Drejtori i Agjencisë, Z. Dukaj, foli para studentëve për punën që po bëjnë institucionet e Kosovës në mbrojtjen e pronësisë intelektuale, mbi të drejtat e pronësisë industriale, regjistrimin dhe përfitimin nga regjistrimi i objekteve të pronësisë industriale.



Në kuadër të muajit të pronësisë intelektuale, institucionet e pronësisë intelektuale mbajtën ligjeratë në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini". Agjencia u përfaqësua nga Drejtori Dukaj. Ai i informoi studentët mbi regjistrimin dhe përfitimet nga pronësia industriale.



Më 26 Prill të çdo viti, festohet Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale për të promovuar rëndësinë e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale. Për këtë vit Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), zgjodhi të festoj me moton: “Pronësia Intelektuale dhe Rinia”. Motoja e këtij viti, e zgjedhur nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale i dedikohet rinisë e cila nëpërmjet kreativitetit dhe zgjuarsisë po nxisin ndryshimet dhe po trasojnë shtigje drejt një të ardhme më të mirë për globin. Agjencia mori pjesë në disa aktivitete të organizuara për shënimin e kësaj dite:

Në emisionin e mëngjesit në RTK Z. Dukaj foli mbi regjistrimin e pronësisë industriale me theks regjistrimin e shpikjeve përmes patentave.



Në Radio Televizionin 21, Agjencia u përfaqësua nga znj. Nderime Dumani. Gjatë emisionit Znj. Dumani foli mbi regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale dhe përfitimet e bizneseve pas regjistrimit të tyre.



Një delegacion nga Agjencia mori pjesë në Konferencën Kombëtare të Pronësisë Intelektuale në Republikën e Shqipërisë. Ky aktivitet është pjesë e aktiviteteve të përbashkëta në mes të dy zyreve homologe. Vitin tjetër Kosova do të jetë nikoqir i organizimit të Konferencës Kombëtare të Pronësisë Intelektuale.



Aktivitet me studentë për shënimin e ditë botërore të pronësisë intelektuale përfshinë ligjeratën e mbajtur në Fakultetin Juridik, ku Drejtori Dukaj foli mbi zbatimin e pronësisë industriale, të drejtat ekskluzive të fituara me regjistrimin e tyre dhe përfitimet nga regjistrimi i objekteve të pronësisë industriale.



Agjencia për Pronësi Industriale mori pjesë në Panairin e Përgjithshëm Ndërkombëtar, Prishtina 2022. Ky aktivitet realizohet në kuadër të planit të punës për promovimin e pronësisë industriale. Gjatë panairit Agjencia realizoi takime me bizneset për ta promovuar rëndësinë e mbrojtjes së produkteve me markë tregtare, patentë apo dizajn industrial.



Është mbajtur trajnimi 2 ditor për Udhëzuesin e Markave Tregtare. Udhëzuesi i markave është përgatitur përmes projekt IPR dhe përfshinë procedurat për implementimin e Ligjit për Marka Tregtare. Ky udhëzues do të krijoj bazën për ekzaminimin e markave tregtare në mënyrë standarde dhe të njëjta sipas praktikave dhe interpretimeve të rasteve të zyrave dhe gjykatave evropiane.

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes Agjencisë dhe Drejtorisë së Pronësisë Industriale të Shqipërisë, u mbajt trajnimi specifik për zyrtarët e Agjencisë. Trajnim u mbajt në Tiranë në datat 6-10 Qershor 2022. Zyrtaret u trajnuar në fushën e markave tregtare.



U mbajt Punëtorja “Metodologjia e promovimit të të drejtave të pronësisë industriale për bizneset dhe palët e interesuara”. Kjo punëtori u mbajt me ndihmën e projektit LuxDev. Në këtë aktivitet janë përgatitur dhe 5 materiale promovuese për sektor të veçantë në fushën e pronësisë industriale. Këto 5 materiale promovuese përfshinë:

- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
- Pajisjet Teknologjike dhe DPI
- Materialet Ndërtimore dhe DPI
- Bujqësia dhe DPI
- Industria e Modës dhe DPI

Punëtori me prodhuesit potencial të treguesit gjeografikë në Prizren. Në këtë punëtori u ligjerua mbi rëndësinë e mbrojtjes së produkteve dhe tregues gjeografikë. Pjesëmarrës ishin disa prodhues të kulturave të cilat mund të prodhojnë aplikime për tregues gjeografikë.



Janë publikuar 2 video promovuese për Marka Tregtare dhe Pronësi Intelektuale. Këto video janë realizuar dhe financuar nga projekti IPR dhe do të shërbejnë për ngritjen e vetëdijes për regjistrimin e pronësisë intelektuale në Kosovë.



Në datat 7, 8 dhe 9 Qershor është mbajtur trajnimi me temën "Luftimi i Piraterisë Digjitale". Në takim morën pjesë dhe zyrtarët e Agjencisë për Pronësi Industriale, Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe përfaqësuesit e Policisë dhe Prokurorisë

Një delegacion nga Agjencia për Pronësi Industriale mori pjesë në Tiranë në Konferencën për ta prezantuar Strategjinë e Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë. Ky aktivitet është realizuar në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe planit për realizmin e aktiviteteve të përbashkëta.



Zhvillimi i platformës së statistikave të IPR ka përfunduar. Më 21 Prill është mbajtur trajnimi për institucionet e zbatimit të ligjit, si Policia, Inspektorati dhe Dogana. Trajnimi u mbajt mbi mënyrën e përdorimit të kësaj platforme. Krijimi i kësaj platforme është financuar dhe koordinuar nga projekti IPR. Për funksionalizimin e tij mbetet të merret vendimi mbi vendin e hostimit të kësaj platforme. Përmes kësaj platforme institucionet e zbatimit të ligjit të IPR do të raportojnë statika të zbatimit të të drejtave të pronësisë industriale e intelektuale në përgjithësi. Përmes gjenerimit të raportit statistikor parashikohet të mblidhen të dhënat dhe të vendosen politika dhe nisma për avansimin e zbatimit të pronësisë industriale.

Me ftesë të Zyrës homologe të Kroacisë, një delegacion i Agjencisë ka vizituar zyrën për pronësi industriale ku janë njoftuar mbi procedurat e regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale me theks markat tregtare dhe kundërshtimet ndërmjet markave tregtare.




Në datat 5-9 Dhjetor, zyrtarët e Agjencisë vizituan Drejtorinë për Pronësi Industriale të Republikës së Shqipërisë dhe u trajnuan në temat mbi komisionin e akteve, dhomën e kundërshtimeve, dhomën e shfuqizimeve dhe zbatimin e strategjive të PI.

Agjencia për Pronësi Industriale ka qenë e ftuar nga EUIPO në takim për draftimin e një vendimi në kuadër të vendeve të CEFTA për një kornizë të përbashkët rajonale në fushën e pronësisë intelektuale. Draft vendimi është përgatitur nga grupet teknike dhe do të dërgohet për konsultime të mëtutjeshme për miratim nga pikat kontaktuese. Ky projekt është pjesë e planit të përbashkët rajonal të quajtur Common Regional Market 2021-2024. Qëllimi i projektit është eliminimi i barrierave tregtare në fushën e pronësisë intelektuale në mes të vendeve të CEFTA.

Projekti i IPR i financuar nga BE, organizoi vizite studimore për zyrtarët e Agjencisë për Pronësi Industriale - API, Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe Dogana e Kosovës, në Athinë të Greqisë.



Është krijuar një adresë digjitale për pronësinë intelektuale nga projekti IPR. Kjo faqe synon të rrisë më tej vetëdijën për rolin dhe rëndësinë e pronës intelektuale në Kosovë. Këtu shpjegohen konceptet bazë duke përdorur media të ndryshme, synon të edukojë shfrytëzuesit përmes publikimeve dhe liston ligjet dhe palët e interesuara për të përmbledhur të gjithë ekosistemin e sektorit të pronësisë intelektuale. Për qasje në web është krijuar domeni <https://www.pronesiintelektuale.com/>.



Me një ceremoni është përmbyllur projekti i EU për IPR në Kosovë. Ky projekt ka zgjatur për tre vjet e gjysëm dhe ka pasur si qëllim fuqizimin e sistemit të pronësisë intelektuale në Kosovë me 3 objektiva kryesore si: Përmirësimi i legjislacionit primar dhe sekondar, fuqizimi i kapaciteteve administrative të institucioneve në fushën e pronësisë intelektuale dhe promovimi i pronësisë industriale në të gjithë pjesën e shoqërisë.




Janë përgatitur dhe publikuar në web faqen www.kipa.rks-gov.net disa materiale promovues për pronësinë industriale. Materialet promovuese përfshijnë: Doracak për Patenta, Doracak për Marka Tregtare, Doracak për Dizajnet Industriale, po ashtu Doracaku për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Originës

7. Të hyrat financiare

Agjencia realizon të hyra të cilat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë në shumën **399,350.00** euro. Për realizimin e këtyre të hyrave janë gjeneruar **6829** fletëpagesa. API ka sistemin e saj online të gjenerimit të fletëpagesave përmes web faqes së saj, ky shërbim ka mundësuar zvogëlimin e kohës për aplikimin dhe qasje në shërbimet e API-së.

Për këtë vit Agjencia për Pronësi Industriale ka rritur të hyrat për **8.2%**.



8. Të arriturat kryesore

Agjencia për Pronësi Industriale në bashkëpunim me donatorët dhe stafin e MINT ka arritur të përgatitë ndryshimet e nevojshme ligjore për të plotësuar zotimet e marra në MSA mbi pronësisë industriale. Kjo reformë ligjore ka përfshirë ndryshimin e ligjeve të pronësisë industriale dhe miratimin e një ligji të ri për sekretin tregtare. Ligjet e miratuara tashmë janë në përputhje të plotë me Aquies-BE në fushën e pronësisë industriale.

Janë miratuar dhe hyre në fuqi këto ligje:

- Ligji Nr. 08 L/059 për Patentat;
- Ligji Nr. 08 L/055 për Dizajnin Industrial;
- Ligji Nr. 08 L/053 për Tipografisë e Gjysmëpërçuesve;
- Ligji Nr. 08 L/076 për Mbrojtjen e Sekreteve Tregtare;
- Ligji Nr. 08 L/075 për Marka Tregtare.

Gjithashtu në kuadër të plotësimit të infrastrukturës nënligjore janë miratuar këto Udhëzime Administrative:

- Është miratuar Udhëzimi Administrativ nr. 05/2022 për Caktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Përdorimin e Logos së Agjencisë për Pronësi Industriale;
- Udhëzimi Administrativ nr. 10/2022 për Kompetencat, Mandatin dhe Punën e Komisionit të Ankesave Kundër Vendimeve të Agjencisë për Pronësi Industriale;
- Udhëzimi Administrativ nr. 13/2022 për Përfaqësues të Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale;
- Udhëzimi Administrativ nr. 14/2022 për Procedurat e Regjistrimit të Patentave.

Agjencia ka organizuar disa trajnime për fuqizimin e kapaciteteve administrative të stafit të saj. Stafi është trajnuar për praktikat më të mira të shqyrtimit të aplikimeve për objektet e pronësisë industriale. Për ta pasuar me të lehtë shqyrtimin e aplikacioneve, projekti i EU për IPR ka përgatitur dhe udhëzuesit për ekzaminim të cilat do të shfrytëzohen nga zyrtarët e Agjencisë.

Në fushë e ngritjes së vetëdijes mbi rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë industriale janë mbajtur një numër i madh i aktiviteteve me akter të bizneseve dhe shoqërisë, e po ashtu janë publikuar disa materiale promovuese. Për këto me mbështetjen e projektit është krijuar një web faqe e veçantë për pronësinë intelektuale ku palët tashmë të gjitha videot apo materialet promovuese mund ti gjejnë të përmbledhura. Këto aktivitete kanë rezultuar me shtimin e numrit të aplikimeve për marka tregtare me pronar vendor, ku në krahasim me vitin e kaluar kemi një rritje të aplikimeve vendore për 12.86% dhe rritje e të hyrave për 8.2%.

Agjencia ka filluar me lëshimin e vendimeve për kundërshtimin e markave tregtare. Pas një procesi të gjatë ku janë trajnuar zyrtarët e Agjencisë, këtë vitë për here të parë që nga themelimi i Agjencisë, është filluar për mos u ndalur me lëshimin e vendimeve për kundërshtimin e MT, dhe me këtë është zgjedhur problemi me i madhe që ka ekzistuar ne API ndër vite.

Ky rast konsiderohet dhe është një e arritur e madhe për Agjencinë për Pronësinë Industriale dhe gjithë sistemin e mbrojtjes dhe regjistrimit të pronësisë industriale në Kosovë, pasi ky proces i bllokuar deri më tani ka gjetur zgjidhje të përhershme.

Agjencia për Pronësi Industriale siç është theksuar vazhdimisht në raportet e KE dhe mekanizmave të tjerë, ka mungesa e resurseve humane dhe vepron me një staf të limituar për kryerjen e shërbimeve sipas mandatit të saj ligjor, andaj sfidat kryesore të saj janë mungesa e resurseve humane për kryerjen e shërbimeve nga palëve.

9. Donatorët

Gjatë këtij viti Agjencia për Pronësi Industriale është mbështetur nga disa donator përmes programeve të tyre:

1. IPA 2017 Project “ EU Support for the Intellectual Property Rights in Kosovo”, projekti 3 vjeçar i filluar në Tetor 2019, përfundon më 18 Tetor 2022.
2. Technical Assistance by Luxembourg-Development – projekti mbështet disa aktivitete në forcimin e kapaciteteve.

KONTAKTI



Agjencia për Pronësi Industriale
Agencija za Industrijsku Svojinu
Industrial Property Agency

MINISTRIA E INDUSTRIISË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë / Republika e Kosovës

Website: www.kipa.rks-gov.net

E-mail: isa.dukaj@rks-gov.net

Tel: +383 38 200 36 554

Orari i pritjes: E hënë – E premte 08:00 - 16:00